



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"
"Procedure Prokurimi për Organizimin e "Trajnimi i Trajnereve të Volejbollit nga CEV në Qarkun e Durrësit".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Njësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Procedure Prokurimi per Organizimin: “Trajnimi i Trajnereve te Volejbollit nga CEV ne Qarkun e Durrësit ”	Kerkojme subjekte ku secili prej tyre te mbuloje sherbimet si me poshte: Realizim eventesh te ngjarjeve sportive i cili ofron sherbimet dhe materialet si: -Akomodim + mengjes - Darke -Catering - Sherbim projekcioni	Numer sherbimesh	Sherbime	1.500.000 leke	1.500.000 leke	Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	2 dite (24-25 Janar 2025) Organizimet e eventeve sipas kalendarit te miratuar nga Ekipet Sportive

4. Metodologjia dhe plani i punës

Në kuadër të kësaj procedure prokurimi, do të përzgjidhet individ, ekipi apo kompania që paraqet ofertën më të përshtatshme për organizimin e trajnimit të trajnerëve të volejbollit nga CEV në Qarkun e Durrësit. Organizimi do të realizohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e CEV.

Plani i punës përfshin:

- **Koordinim të ngushtë me CEV** për përmbajtjen dhe strukturën e trajnimit, kalendarin e aktiviteteve dhe përbërjen e pjesëmarrësve.
- **Përzgjedhjen dhe përgatitjen e ambientit të përshtatshëm** për zhvillimin e trajnimit (salla sportive, hapësira ndihmëse, fushë volejboli me standarde, etj.).
- **Sigurimin e pajisjeve dhe materialeve** të nevojshme për trajnimin (volejbolla, rrjeta, konet, tabela, pajisje audiovizive, etj.).
- **Asistencë logjistike për përfaqësuesit e CEV**, përfshirë pritjen, transportin dhe akomodimin e tyre në rast se është e parashikuar.
- **Menaxhimin e procesit të trajnimit** nga fillimi deri në fund, duke përfshirë ndihmën gjatë sesioneve, shpërndarjen e materialeve trajnimi, mbajtjen e evidencave dhe përgatitjen e raportimit përfundimtar.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Qëllimi i këtij aktiviteti është të sigurojë një trajnim cilësor dhe të standardeve ndërkombëtare, që do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve të trajnerëve lokalë dhe zhvillimin profesional të tyre në fushën e volejbollit.

5. Kualifikimet e nevojshme

Për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ofertuesit duhet të përmbushin këto kritere:

- **Të kenë të paktën 4 vite përvojë** në organizimin e aktiviteteve sportive apo trajnimeve profesionale, në veçanti në fushën e volejbollit ose sporteve të ngjashme.
- **Të kenë eksperiencë të dokumentuar** në bashkëpunime me organizata ose federata sportive ndërkombëtare, veçanërisht në organizimin e trajnimeve apo seminareve me pjesëmarrje ndërkombëtare.
- **Të zotërojnë kapacitetet logjistike dhe teknike** të nevojshme për të garantuar një organizim cilësor, përfshirë pajisjet sportive, ambientet trajnimi dhe infrastrukturën ndihmëse.
- **Të kenë staf të kualifikuar dhe me përvojë** në menaxhimin e eventeve sportive dhe të jenë në gjendje të koordinojnë me partnerë ndërkombëtarë.
- **Të jenë subjekte të regjistruara ligjërisht**, pa detyrime të pashlyera ndaj shtetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet publike.

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte.

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

7. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 17.01.2025 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

8. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%
Staf dhe pajisjet teknike të nevojshme për organizimin e eventit.	40%

9. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.